

VËSHTRIM NGA ATHINA

Greçia dhe fqinjët e saj shqiptarë

Konteksti dhe kushtet e një bashkëpunimi total strategjik me faktorin shqiptar



Alexandros Mallias

Festimi i 100-vjetorit të themelimit të shtetit të pavarur të Shqipërisë gjen marrëdhëniet politike të Greçisë me vendin tonë fqinj në gjendje statike dhe guxoje të theksojë në gjendje amullie. Karakterizohen nga mungesa e lëvizjes dhe e energjisë pozitive. Kontaktes politike midis dy vendeve janë të kufizuara. Bëhen zakonisht në kuadër të ndonjë takimi ndërkombëtar. Asnjëherë në të kaluarën – me përjashtim njëzetmuajshin e "gurtë" korrik 1993 - mars 1995 – nuk kishim një mungesë të tillë kontaktesh, vizitash, dialogu konstruktiv dhe konsultimesh dypalëshe në nivel politik.

Dhe të mos harrojmë se me vendim të samitit të NATO-s në Bukuresht, para tre vjetësh, Greçia dhe Shqipëria janë aleatë.

Ndërkohë Athina, që nga viti 2010, ka zgjedhur të nënvlerësojë kontaktet dypalëshe dhe konsultimet me Tiranën në nivelin funksional të sekretarit të përgjithshëm. Konsultimet zyrtare dhe kontaktet e këtij niveli janë të zakonshme për shembull në marrëdhëniet midis shteteve të Bashkimit Evropian. Ministrat e BE-së takohen rregullisht. Pothuajse çdo javë. Por në Ballkan, vetëm si mungesë interesi apo si ligështim mund të karakterizohen. Të krijojnë nga njëra anë përshlypjen e gatishmërisë dhe dispozicionit, por pa dhënë rrugëzgjidhje konkrete. Nuk mund të japin rrugëdalje, të shkaktojnë zhbllokimin. Sidomos kur kjo gjendje e mbetur pezull kërkon përgjegjësi politike dhe vendosmëri.

Pala greke vlerëson se me këtë mënyrë kundërvendron në tërheqjen e Shqipërisë nga ratifikimi i marrëveshjes për caktimin e kufijve të zonave detare dhe të Shelfit kontinental si dhe në ceremonitë e bezdisshme, tashmë të organizuara të formacioneve politike që kanë lidhje me të ashtuquajturën popullsi çame. Gjithashtu, në lidhje me minoritetin etnik grek.

Në realitet, mungesa e një plani të kompletuar me fillim, mes dhe mbarim me angazhimin e vërtetë të qeverisë greke në kërkim të një rrugëdaljeje si dhe zgjidhjeve në nivel politik, kudo që të jetë e mundur, nuk është diçka që shqetëson apo preokupon Shqipërinë.

Pse? Përgjigjia është e thjeshtë: Sepse pala shqiptare – si qeveria e kryeministrit Sali Berisha ashtu edhe opozita e socialistit Edi Rama – konsiderojnë nga ana e tyre se Greçia e sotme është e dobët dhe e ngurosur si dhe, sipas Tiranës, nuk ka vullnetin, ndoshta edhe mundësi, të diskutojë dhe të përparojë në përbalimin e disa çështjeve të caktuara.

Deri kohët e fundit, ndoshta akoma edhe sot, Greçia trajton Shqipërinë dhe shqiptarët me ndjenja kontradiktore frike dhe fudullëku. Shqipëria, kryesisht stafi politik dhe gazetaresk i Tiranës, e trajtojnë Greçinë me frikë, dyshim dhe pasiguri. Tre vitet e fundit u shtua edhe fudullëku.

Athina shprehë habinë nëse në Tiranë kanë me të vërtetë një axhendë të dukshme kundër Greçisë (çështja e Çamërisë) dhe në Tiranë shqetësohen akoma – për fat të keq – në Greçia ka një axhendë të fshehtë. Në këtë mënyrë interpretojnë edhe mbajtjen nga ana e Athinës, të një qëndrimi të paqartë në lidhje me fuqinë e pasojave ligjore të të ashtuquajturit Ligjit të luftës.

Në realitet, në marrëdhëniet tona nuk mund të thuash se dominon logjika. Dominon logjika e prononcimeve publike dhe e keqinterpretimit. Dominon një anakronizëm.

Specialiteti që nevojitet në mënyrë urgjente për diagnostikimin e saktë të marrëdhënieve midis dy vendeve, është ai i psikoanalistit dhe jo ai i diplomatit. Kjo nuk do të thotë që diplomacia nuk është gjithashtu një ushtrim i vazhdueshëm i psikologjisë.

Gjithashtu nuk duhet të nënvlerësohet rëndësia dhe përmatat e ndërhyrjeve dhe ndërmjetësimeve të vendeve të treta si Serbisë, Turqisë dhe Italisë në marrëdhëniet e Athinës me faktorin shqiptar. Në mënyrë të dukshme apo të padukshme.

Kam përshtypjen se si Tirana ashtu edhe Athina ndoshta "voliten" nga kjo gjendje e sotme. Në Athinë ndërhyrja jonë politike fillon

dhe mbaron me deklaratat e zëdhënësit të talentuar të Ministrisë së Jashtme. Në realitet, zgjatja e gjendjes së sotme nuk u shërben interesave të Greçisë, ndërkohë që dobëson vazhdimisht edhe rolin e përgjithshëm që aspiron apo ndoshta aspironte që të luante.

Në Tiranë, dëgjoj gjithnjë e më shpesh deklarata të paqarta, zyrtare dhe gjysmëzyrtare, të cilat nuk të çojnë diku dhe nuk ka mundësi të sjellin diçka pozitive.

Gjithashtu kam përshtypjen se nënkryetari i Qeverisë dhe ministri i Jashtëm, Edmond Haxhinasto, i cili teorikisht i përket brezit të ashtuquajtur të politikaneve bashkëkohorë, duhej të evitonte deklaratat përçmuese dhe përbuzëse për gatishmërinë të pranojë "emigrantë grekë në Shqipëri".

Jo për gjë tjetër, por me këtë antipatinë e tij duket se po justifikon ata të cilët në Greçi, para njëzet vjetësh, u sollën me përbuzje ndaj emigrantëve shqiptarë të cilët kaluan më këmbë kufirin për të mbijetuar.

Qëndrimi në vendnumëro që dominon sot në marrëdhëniet e Greçisë me Shqipërinë, në kombinim me çështjen e mbetur pezull të njohjes së Republikës së Kosovës, mund të përbëjnë shtyllën kurrizore të politikës sonë totale në marrëdhëniet me fqinjët shqiptarë?

Sepse nëse mbesim thjesht në diagnozën dhe në vëzhgimin pasiv të gjendjes nuk shoh mundësinë për të dalë, në të ardhmen e afërt, nga hendeqet.

Rreth para një viti, kisha rastin të paraqes në Ministrinë e Jashtëm një propozim total - kontekst për zgjidhjen e çështjeve të pazgjdhura midis Greçisë dhe Shqipërisë, Kosovës dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë. Që atëherë deri më sot vazhdoj të shpreh mendimet e mia me intervista në gazetën "Utrinski Vesnik" e Shkupit, "Koha Ditore" e Kosovës dhe "Gazeta Shqiptare" e Tiranës.

Gjithashtu kam diskutuar me udhëheqës shqiptarë, politikanë, gazetarë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, emrat e të cilëve nuk i referoj qëllimisht.

Reagimi i tyre fillimisht ishte pozitiv, megjithëse disa e konsideruan procedurën të ndërlikuar. Një artikull në lidhje me këtë temë u publikua në revistën "Mbrojtja dhe diplomacia" (Dhjetor 2011).

Po parashtroji tri parime të domosdoshme e njëkohësishme me prioritet për politikën greke:

- Së pari, të zgjidhen përfundimisht çështjet e pazgjdhura me Shqipërinë në kuadër të një procedure për njohjen e Kosovës.

- Së dyti, të shënohet një qasje e përgjithshme e Greçisë me shqiptarët në tri vendet tona fqinje (Shqipërinë, Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Kosovën).

- Së treti, Greçia të sigurojë, nëpërmjet kësaj procedure, një zgjidhje të kënaqshme në çështjet që e interesojnë dhe e preokupojnë.

Letra më e konsiderueshme që ka sot Greçia në duart e saj, por jo për kohë të papërcaktuar, është njohja e Republikës së Kosovës nga Greçia. Kjo presupozon fillimin e një dialogu politik, një proces nga i cili Greçia do të ketë për qëllim sigurimin e interesave të saj. Platforma e propozuar përfshin sa më poshtë:

- fillimin e një dialogu politik midis Athinës dhe Prishtinës me synim përpunimin e një teksti të pranueshëm nga të dyja palët, i cili do të ketë formën e Marrëveshjes apo Paktit. Në vazhdim, do të paraqitet për ratifikim në Parlamentin grek si dhe në Parlamentin përkatës të Kosovës.

- Sigurimin e interesave të Greçisë në lidhje me faktorin e përgjithshëm shqiptar në vendet fqinje me Greçinë (Shqipëri, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova).

- Braktisja në realitet dhe jo vetëm në fjalë nga Shqipëria dhe nga disa grupe dhe organizata të caktuara shqiptare, e çështjeve të bezdisshme për Greçinë, të cilat paraqiten me intensitet të pazakonshtëm dhe ushqejnë, negativisht, opinionin publik.

- Ndryshim qëndrimi nga mediat shqiptare dhe largim nga retorika aktuale e disa politikaneve shqiptarë kundër Greçisë.

- Çështje që i përkasin minoritetit etnik grek në Shqipëri.

- Heqja e pengesave për ratifikimin e Marrëveshjes për caktimin e kufijve të zonave detare dhe të Shelfit kontinental.

- Rregullim legjislativ nga Greçia të heqjes së



Autor: Jeton Mikullovc

"Gjendjes së luftës" me Shqipërinë. Bëhet fjalë për një situatë e cila mund të kombinojë me modifikimin e një neni të Marrëveshjes për caktimin e Shelfit kontinental, me qëllim që me ratifikimin e saj nga parlamentet e Greçisë dhe Shqipërisë, të evitohet çdo keqkuptim që ka lidhje me kufijtë tokësorë e detarë midis dy vendeve aleate.

Është e vetëkuptueshme se brenda kësaj procedure Greçia do të tregojë kujdes për ruajtjen dhe sigurimin e interesave të saj. Rregullit themelitar i kësaj negociate do të jetë "asgjë nuk konsiderohet e miratuar n.q.s. nuk ekziston një marrëveshje e përgjithshme". Ose nëse ju preferoni ndryshe "nuk ekziston marrëveshje e pjesshme pa marrëveshje totale".

Njohja e pashmangshme "nesër" e pavarësisë së Kosovës nga Greçia duhet të përbëjë një procedure, e cila duhet të fillojë sot. Nuk është diçka e cila do të ndodhë me automatizime. Gjithashtu, mirë

është që Greçia të shohë pak dhe interesat e saj jashtë kuadrit që cakton apo që na thotë se cakton Beogradit. Serbia është në gjendje – dhe ndërkohë e zbaton mbas portave të mbyllura në Bruksel – të mbështetë dhe të promovojë interesat e saj në lidhje me Shqipërinë dhe Kosovën. Të mira janë miqësitë e njëanshme diakronike, por më e preferuar është përpjekja për sigurimin e interesave greke.

Duhet, gjithashtu, të eliminojmë pikëpamjen dominuese se ekziston një grup me pesë shtete anëtare të BE-së, të cilat nuk njohin Kosovën. Nuk ekziston një grup i tillë. Këto shtete nuk veprojnë si grup. Për secilin shtet ekzistojnë interesa dhe shqetësime të ndryshme, të cilat kanë çuar në mosmarrjen e vendimit për njohje. Shkaqet që pengojnë Spanjën janë krejt të ndryshme nga ato të Greçisë.

Është e sigurt se rol frenues në politikën greke dhe në stimulimin e predispozicionit negativ të opinionit publik grek kanë luajtur vitet e fundit pozicionimi i mediave shqiptare në Tiranë. Nuk ndihmojnë mbështetjen e nevojshme të një përfaqëse të Greçisë me Prishtinën dhe as në njohjen e Kosovës. Gjithashtu nuk ndihmojnë aspak deklaratat dhe veprimet e disa politikaneve shqiptarë si dhe disa grupeve konkrete.

Theksoj se Traktati greko-shqiptar i miqësisë, bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe sigurisë, nënshkruar më 21 mars 1996 në Tiranë, hyrë në fuqi më 9 mars 1998, ka mandat njëzetvjeçar dhe, si pasojë, datë skadimi. Sipas nenit 20 par. 2, afati i tij rinovohet automatikisht për një pesëvjeçar, përveç rastit kur njëra palë kontraktuese njofton me shkrim palën tjetër për vendimin e saj ta denoncojë këtë traktat, të paktën një vit

para skadimit të afatit. Mirë do të ishte si Greçia ashtu edhe Shqipëria të rinisin bisedimet dypalëshe sipas nenit 17, të cilat kishin filluar në shtator të vitit 2004. Me qëllim që të mos ndodhën përrapa surprizave.

Për sa u përket shqiptarëve të Shkupit, në këtë moment të dallive nacionaliste të drejtuara nga z. Gruevski, shqiptarët e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, të zhgënjyer për shkak të largimit të perspektivës së anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Evropian, kanë për herë të parë shansin historik dhe mundësinë të arrijnë atë në të cilën dështoi – sepse ajo ishte zgjedhja e liderëve të saj – shumica sllavomaqedonase.

Si? Me nënshkrimin e një deklaratë të bashkëpërshme nga të gjithë krerët e politikës shqiptare në Shkup dhe në Tetovë, duke lënë mënjanë mosmarrëveshjet personale dhe partiake midis tyre dhe duke marrë iniciativën:

1. Të ndërtojnë urrën e mirëkuptimit me Greçinë, duke marginalizuar klasën politike nacionaliste të Gruevskit.

2. Të veprojnë si një katalizator në zgjidhjen e çështjes së emrit.

3. Të çojnë vendin e tyre drejt NATO-s dhe drejt Bashkimit Evropian.

Dhe diçka akoma. Le të mos nxitojë z. Gruevski me njetet e varura dhe të kontrolluara të komunikimit masiv, të na akuzojnë përsëri duke shpifur se gjoja Greçia po evokon "komplotet të errëta" me shqiptarët kundër vendit të tij. Realiteti është ndryshe. Shqiptarët e Shkupit, n.q.s. ata vetë e ndërgjegjësojnë dhe e dëshirojnë, mund të arrijnë për atdheun e tyre objektivat, të cilat politika nacionaliste ua ka larguar.

Procedura dhe perspektiva për një bashkudhëtim, duhet dhe mund të bëjë të qartë se sa e rëndësishme është Greçia për shqiptarët dhe në Greçi sa i rëndësishëm është roli që kanë në Ballkan fqinjët tanë shqiptarë.

Një koleg i mirë, nga njohësit më të thellë të Shqipërisë, i cili lexoi këtë tekst, më tha se në disa pika është disi idealiste.

Mund të pretendoj se me të vërtetë përfrimi që sugjeroj është shumëdimensional dhe i vështirë. Kërkon hapa të kujdesshëm e konkretë, e mbi të gjitha njohje të shkëlqyeshme të mjedisit dhe të personave që drejtojnë timonin. Kërkohe lëvizshmëri, kreativitet, imagjinatë dhe dinamizëm. Pra kërkohe e kundërta nga karakteristikat që kanë lëvizjet e deritanishme që shquhen për burokracinë e tyre statike. Nevojitet diplomaci e paraskenës dhe prapaskenës, si dhe marrëdhënie personale konfidenciale me shqiptarët. Por mbi të gjitha kërkohe të vijozohet një linjë në aspektin politik.

(Alexandros Mallias, ish-ambasador grek në SHBA, është "Ambasador nderi" i Greçisë dhe ka përvujtë të madhe në rajonin e Ballkanit. Ky shkrim është botuar fillimisht në ueb-faqen greke "Metarrythmisi" ("Reforma"), ndërsa "Koha Ditore" e riboton me lejen e autorit.)